



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	11.12.2023	18.12.2023	2023/0987

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.12.2023, OE “LK Solutions SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0987, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pajisje te laurave”, me nr. të prokurimit: 701-23-10905-1-2-1, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlere e parashikuar e kontrats: 44,090.00 €, me Nr. 2023/0987 i dt: 06.12.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pasi qe ne opcionin per thirjen e kerkeses se rishqyrtimit ne platformen e eprokurimit nuk ofrohet , helpdesku i e-prokurimit na keshilluan ta bejme ne menyre manuale dokumentet e kerkuara.

Kerkesa per rishqyrtim nga OE

Te nderuar

Ne Vendimin e anulimit keni arsyetuar se “ Gjate vleresimit eshte verejtuar se ka mosperputhje te sasise se tiketave te parkingut ku ne ST te detyrueshme figuron kutia prej 5000 cope kurse ne pershkrim te cmimit 3000 cope dhe eshte ofertuar po me ate sasi . Andaj propozohet anulimi I kesaj procedure te prokurimit“ Ne SP fillimisht ka pasur gabime dhe mungese te specifikave, ku ju keni sqaruar me date 25.10.2023 dhe keni vendosur specifika te reja dhe te permirsuara.

Ne SP te dosjes ka pasur mungese te specifikave per produktet e pozicionit 8 , 9 , 10 , 11 dhe ne

sqarim jane vendosur keto specifika qe kane munguar . Gjithashtu ne SP te dosjes pozicioni I 6 eshte kerkuar FRONT PANEL PLEXIGLASS ndersa ne sqarim eshte vendosur Automatic Barriers. Ne pozicionin e 3,4,7 eshte shenuar vetem emri produkti pa asnje specific , ndersa ne sqarim eshte nderruar produkti I pozicionit 7 dhe jane vendosur specifikacioni.

Sipas specifikave te sqarimit te gjitha produktet perputhen me pershkrim te cmimit. Ne pozicionin e 1 te letres ne specifikat e sqarimit eshte specifikuar edhe dimensioned e letres ndersa nuk eshte vendosur numri I sasise. Kutiat STANDARDE te tiketave eshte 3000 ndersa ne raste te veqanta kerkohet mbi kete numer qe nuk preferohet per arsye se kutia ka dimension standard ndersa tiketat duhet te shtypen me teper . Prandajj duke u bazuar ne standarte te kutise, pershkrimin te cmimit me sasi 3000 dhe pasi qe nuk eshte vendosur sasia ne sqarim kemi ofertuar sipas pershkrimin te cmimit.

Sipas LPP Neni 53 Pika 7 OE obligohet qe te ofertohej sipas sqarimit te ofruar nga AK. Atehere vleresimin e tenderit ju si AK e keni bere nga SP te dosjes e jo nga SP te sqarimit, ku sipas SP te dosjes ka munges dhe gabime te shumta. Si eshte bere vleresimi duke u bazuar ne 2 specifika paralele ? Ne kemi ofertuar sipas specifikave te sqarimit me perpiqmeri ku edhe pershkrimi I cmimit eshte i njejt.

Supozojme: se anulimi I ketij aktiviteti te prokurimit eshte ne kundërshtim me LPP. Kerkojme qe te behet rivleresimi I ketije aktiviteti te prokurimit , duke u bazuar ne sqarimin e specifikave qe ju I keni vendosur ne platformen e prokurimit, Jemi te gatshem si OE te dorezojme kutine prej 5000 tiketave sipas specifikave te vjetra te dosjes.

Pergjigja e AK

Pergjegjja nga njesia kerkuese eshte si ne vijim: Ne si komision I vleresimit e kemi pare qe nuk perputhet pershkrimi I qmimit me specifikat e detyrshme teknike ku ne pershkrim te qmimit figuron Tiketa te parkingut kuti 3000 cope kurse ne Specifikime teknike figuron Bileta duhet te liferohen ne kuti 5000 cope. Edhe ju si OE e keni pasur mundesin qe te kerkoni sqarime paraprakisht per kete mosperputhje. Andaj duke u nisur nga ky fakt refuzohet kerkesa per rishqyrtim. Me respekt

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit SHSKUK ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5)

ditë nga marrja e njoftimit të SHSKUK-së, për ne synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do të konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertës dhe SHSKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje).

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit si dhe me informacione të biznesit-Kopje.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N/A

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N/A.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1 Kërkohe Deklaratë për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit si dhe Katalog nga prodhuesi për artikujt e ofruar, ku ofertuesi është i obliguar të nënvizojë specifikimet teknike për po të njëjtit konform specifikave teknike të kërkuara.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1 Deklaratë për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit si dhe Katalog nga prodhuesi për artikujt e ofruar, ku ofertuesi është i obliguar të nënvizojë specifikimet teknike për po të njëjtit konform specifikave teknike të kërkuara.

NJOFTIM PER INFORMATA SHITESHE ose PERMIRESIM I GABIMIT:

Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Evidenca 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit SHSKUK ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të SHSKUK-së, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto

dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertës dhe SHSKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet të cilat do të kërkohen si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje).

Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit., Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit si dhe me informacione të biznesit-Kopje.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1 Kërkohet Deklaratë për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit si dhe Katalog nga prodhuesi për artikujt e ofruar, ku ofertuesi është i obliguar ti nënvizojë specifikimet teknike për po të njëjtit konform specifikave teknike të kërkuara, Evidenca 1 Deklaratë për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit si dhe Katalog nga prodhuesi për artikujt e ofruar, ku ofertuesi është i obliguar ti nënvizojë specifikimet teknike për po të njëjtit konform specifikave teknike të kërkuara.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Deklaratë:

Gjate vleresimit eshte verejtur se ka mosperputhje te sasise se tiketave te parkingut ku ne ST te detyrueshme figuron se kutia duhet te kete 5000 cope kurse ne Pershkrim te çmimeve eshte 3000 cope dhe eshte ofertuar me kete sasi. Andaj propozohet Anulimi i kesaj procedure te prokurimit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **LK Solutions SH.P.K.**

Sqarim fillestar lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Furnizim me pajisje te laurave**”, me numër të prokurimit: **701-23-10905-1-2-1**, të iniciuar nga **AK – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**.

OE ankues: “**LK Solutions**” sh.p.k. Prishtine, pretendimet ankimore i ka parashtruar kundër njoftimit mbi vendimin e AK-se te datës 22.11.2023, ku AK- QKUK ka propozuar anulimin e procedurës së prokurimit.

OE sipas kërkesë për rishqyrtim ka kërkuar rivlerësim të ofertave, ku arsyetimin e eliminimit të kundërshtuar me pretendimet se nuk janë respektuar dispozitat ligjore të LPP-se. Me gjithë atë AK QKUK, sipas vendimit ka refuzuar kërkesën dhe ka lënë në fuqi vendimin e AK-se për anulim të kësaj procedure të prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore:

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në letrën standarde të datës 22.11.2023, kundër OE ankues si arsyetim të eliminimit ka potencuar se “*gjatë vlerësimit është vërejtur se ka mospërputhje të sasive të tiketave të parkingut ku në specifikim teknik të detyrueshëm figuron se kuti duhet të ketë 5000 cope, kurse në përshkrim të çmimeve është 3000 cope dhe është ofertuar me po këtë sasi, prandaj propozohet anulimi i kësaj procedure të prokurimit*”.

Eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi për anulim të aktivitetit të prokurimit në fazën pas hapjes, pas vlerësimit madje pas korrigjimit të gabimit dhe sqarimit të specifikave të obligueshme nuk gjen mbështetje ligjore në dispozitat e ligjit për prokurim publik konkretisht nenit 62 të LPP-se dhe nenit 43 Rregullores Nr.01/2022, paragrafi 43.7 dhe 43.8 përcaktojnë.

43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

43.8 Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsye të mëposhtme:

a. për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku **tre (3) ditë** para hapjes së tenderëve;

b. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm;

c. është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP;

d. nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasojë e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe AK dhe verifikimit e konstatimit nga KRPP-ja.

AK-QKUK me datën 25.10.2023, ka publikuar sqarimet lidhur me specifikacionet teknike të detyrueshme sipas kërkesave të OE-ve ku ka potencuar se specifikimet janë të hartuar thjeshtë duke mos detalizuar në mënyrë që mos të jenë produktet specifike por të ofrohen produkte të ndryshme në mënyrë që të jenë kompatible me pajisjet që operojnë në QKUK. Pajisjet duhet të jenë sipas specifikimeve të ngjashme apo ekuivalente që supertohen nga terminalët ekzistues në mënyrë të që të finalizohen produktet.

Për derisa tek paramasa dhe parallogaria në pozicionin 1, është kërkuar “tiketa të parkingut kuti (3000 cope)”.

Prove: Në E-prokurim gjeni sqarimet e kërkuara nga OE dhe të ofruar nga AK.

AK-QKUK para hapjes të ofertave ka nxjerr edhe njoftim mbi korrigjimin e gabimit ku përveç tjerash është kërkuar edhe deklarate për specifikacionet teknike të detyrueshme, ku OE ankues në oferte ka prezantuar deklaratën e tillë, prandaj Eksperti shqyrtues konsideron se arsyetimi i eliminimit bie ndesh edhe me nenin 52 paragrafi 3, përkatësisht nenin 56 paragrafin 3 të LPP-se, ku përcaktohet se:

“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë të bazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **LK Solutions SH.P.K.**

Burim Guri

